

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përherëshëm i "Shëndetësisë, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazise Gjimore"

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Nr 09, datë 22.12. 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit Datë 22.12.2025, relacionit e dokumentat

P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.12.2025-31.12. 2025".

P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.12.2025-31.12. 2025".

P/Vendim "Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit të buxhetit vendor ose fondit të kushtëzuar, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% (përqind) për vitin 2026".

BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" bazuar në Udhëzimin nr.4, datë 17.02.2017, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7 dhe Vendimi Nr. 868, datë 29.12.2021, masa e ndihmës ekonomike llogaritet:

Baza Ligjore për kriteret e 6%

Referuar dispozitave të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV , pika 1 citon:

"Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike."

Familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar vendor ose fondin e kushtëzuar mbi bllok-ndihmën deri në 6%, përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit, nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyetimin; "nuk ka marrë pikët e mjaftueshme".

Për këto familje duhet të kryhet paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror, për të vlerësuar gjendjen reale.

Situata aktuale e funksionit a)

- a) 2,178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë lekë) për anëtarin e parë të familjes në certifikatën familjare;
- b) 1,525 (njëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;
- c) 1,089 (njëmijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë për anëtarët që janë nën moshën 18 vjeç;

d) 3,146 (tremijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë, kur familja është e përbërë vetëm nga një anëtar i cili është mbi moshë pune, si dhe Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017, për “Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok – Ndihmën Ekonomike deri në 6%”.

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 86 datë, 12.12.2024 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 2.000.000 lekë/ vit.

- a) 2,178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë lekë) për anëtarin e parë të familjes në çertifikatën familjare;
- b) 1,525 (njëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;
- c) 1,089 (njëmijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë për anëtarët që janë nën moshën 18 vjeç;
- d) 3,146 (tremijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë, kur familja është e përbërë vetëm nga një anëtar i cili është mbi moshë pune, si dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017, për “Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok – Ndihmën Ekonomike deri në 6%”.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet) :S KA

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Shëbimit Social

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh: Monitoron Komisioni i “Shendetesise, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazise Gjinore”, dhe Keshilli Bashkiak çdo muaj dhe sa herë e sheh ai të nevojshme

Impakti social / grupet që preken:

Kanë përfituar për muajin dhjetor 48 individë/ familje dhe nga 6% kanë përfituar 6 individë, familje

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

Të trajtohen me Ndihmë Ekonomike për muajin Dhjetor 2025 me fond 19,957 lekë, ku përfshihen 6 (gjashtë) individ/familje sipas kritereve të miratuara.

Të trajtohen me Ndihmë Ekonomike për muajin Dhjetor 2025 nga Fondet e Bashkisë 48 familje në vlerën 142,718 lekë, individ/familje sipas kritereve të miratuara. Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike nga buxheti vetijak ose fondi i kushtëzuar mbi fondin 6% të bllok ndihmës ekonomike janë si më poshtë;

Të miratojë kriteret si mëposhtë vijon:

- 1.Familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur,
- 2.Vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim, kryefamiljar që me vendim gjykatë kanë në ngarkim fëmijë të mitur,
- 3.Familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë ku në përbërje të tyre kanë të paktën 3 të mitur,
- 4.Familje të cilat kanë në përbërje të tyre persona me pagesë paafësie, status verbërie/para-tetraplegjisë/ status invalid pune,
- 5.Familje me një anëtarë mbi moshë pune që nuk përfitojnë pension pleqërie,
- 6.Anëtarë të komuniteteve të marginalizura (rom, egjiptian, emigrantë të rikthyer, LGBT+, familje me vendbanime informale ose zona të izoluar etj...).

A është objekt i konsultimit Publik: Jo

Komisioni i Përhershëm për “ Shëndetësisë, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazise gjinore” , i mbledhur me datën 19.11.2025, shqyrtoi projekt vendimit nr date 22.12.2025 , relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin :

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin dhjetor 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin dhjetor 2025”.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit (3) projektakte në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komision

	Kryetar i Komisionit
<u>(emri/mbiemri, firma)</u>	
<u>(emri/mbiemri, firma)</u>	Sekretar i Komisionit

19.12.2025.